

VENDIM
Nr. 49, datë 12.4.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË NR. 91, DATË 13.5.2019, “PËR PAGESAT E PROKURORËVE PËR
PUNËN E KRYER JASHTË ORARIT”**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenin 11, pika 3, germa “ç”, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenet 159, pika 2, germa “e”, 188, pika 1, dhe 189, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar; nenin 40, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenin 56, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, të Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

I. Neni 7, pikat 2 dhe 3, të vendimit nr. 91, datë 13.5.2019, “Për pagesat e prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit”, ndryshojnë, si më poshtë:

“2. Prokurori që ushtron funksionin në ditët e pushimit javor apo festave zyrtare, si dhe orët shtesë të kryera në orarin 22:00–06:00, për veprime të natyrës urgjente, përfiton shtesë page në masën 50% të pagës së tij ditore në përpjesëtim me orët e punës së kryer ose kompensim me kohë pushimi, por duhet të provojë me dokumentacion shoqërues (aktet hetimore ose vendime të gjykatës) orët e punës së kryer.

3. Prokurori që ushtron funksionin jashtë kohës normale të punës për veprime të natyrës urgjente, përfiton shtesë page në masën 25% të pagës së tij ditore në përpjesëtim me orët e punës së kryer ose kompensim me kohë pushimi, por duhet të provojë me dokumentacion shoqërues (aktet hetimore ose vendime të gjykatës) orët e punës së kryer.”

II. Neni 8, i këtij vendimi, ndryshon, si më poshtë:

“1. Prokurori që është në gatishmëri sipas grafikut të përcaktuar nga drejtuesi i prokurorisë, për shkak të gatishmërisë gjatë ditëve të festave zyrtare apo ditëve pushim përfiton shtesë page në masën 50% të pagës së tij ditore ose kompensim me kohë pushimi sipas pikës 4 të nenit 7.

2. Prokurori i cili është i gatshëm gjatë ditëve të javës por për shkak të gatishmërisë del jashtë orarit zyrtar të asaj dite përfiton shtesë page në masën 25% të pagës së tij ditore ose kompensim me kohë pushimi në përpjesëtim me orët e punës së kryer sipas pikës 4 të nenit 7, por duhet të provojë me dokumentacion shoqërues (aktet hetimore ose vendime të gjykatës) orët e punës së kryer.

3. Prokurori që është i gatshëm gjatë ditëve të javës, por për shkak të gatishmërisë kryen veprime në orarin 22:00–06:00, përfiton shtesë page në masën 50% të pagës së tij ditore në përpjesëtim me orët e punës së kryer ose kompensim me kohë pushimi në përpjesëtim me orët e punës së kryer, sipas pikës 4, të nenit 7, por duhet të provojë me dokumentacion shoqërues (aktet hetimore, vendime të gjykatës etj.) punën e kryer gjatë këtij orari.”

III. Në nenin 9 shfuqizohet fjalia e dytë e paragrafit me këtë përmbajtje:

“Fondi i përcaktuar për orët jashtë orarit nuk duhet të tejkalojë më shumë se 200 orë në vit për çdo prokuror”.

IV. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

V. U shpall në Tiranë, sot, më 12.4.2024.

ZËVENDESKRYETAR
Tartar Bazaj